

Titulli i Projektit	" BAM-PASSARELLA 2012 "
Gjuha e Dokumentit	Shqip
Përgjegjës Unik e-mail:	Federata Shqiptare e Basketbollit, FSHB info@fshb.al
Personat e kontaktit Cel: Tel / Fax: FSHB e-mail:	Andrea Troja Ervin Koçi Fajton MATI 068 20 60 422 067 21 54 377 067 29 31 797, ++355 (4) 222 54 04 / ++355 (4) 225 5850 fajtonmati@fshb.al info@fshb.al
Subjekti Krijues i Projektit Adresa: Tel: Fax: Website: e-mail:	Federata Shqiptare e Basketbollit Rr. "Brigada VIII", P. "Pingulit", H. 3, AP. 1, Tiranë ++355 4 222 54 04 ++355 4 225 58 50 www.fshb.al info@fshb.al
Përgatiti	Fatjon MATI, Ervin KOÇI
Përmbajtja e Projektit	Në aktivitetin Bam-Passarella, marrin pjesë të gjithë ato shoqata që janë anëtare të regjistruara në Federatën Shqiptare të Basketbollit. Mosha pjesëmarrëse do të jenë të gjithë atë që kanë lindur me datë 01.01.1998 ose më vonë. Në këtë aktivitet do të marrin pjesë 12 skuadra të ndara në dy grupe me nga 6 skuadra. Ato do të ndeshen me njëra-tjetrën me sistem rrethi me një takim. Tre skuadrat që renditen të parat në secilin grup, do të kualifikohen për fazën tjetër me po të njejtin sistem (6 skuadra sistem rrethi me një takim). Faza finale do të zhvillohet me datën 01 qershor 2012.
Data e Aprovimit	Mars 2012
Partnerët e Projektit	Universiteti i Sporteve Tiranë, HAKO Sallame dhe Proshuta, Bashkia e Tiranës, Shoqatat pjesëmarrëse në aktivitet dhe mediat audio-vizive dhe ato të shkruara.
Fazat e Projektit	Aktiviteti: Faza e Parë, 24 mars – 21 prill 2012

	Faza e Dytë, 28 prill – 27 maj 2012 Faza finale, 1 qershor 2012
Vendi i Zhvillimit të Projektit	Universiteti i Sporteve Tiranë, salla e lojrave.
Kohëzgjatja e projektit	24 mars 2012 – 01 qershor 2012.
Objektivat e Projektit	Objektivat tona janë: <ul style="list-style-type: none"> • Promovimi i Basketbollit në Shqipëri • Aktivizimi i shumë grupmoshave në këtë aktivitet. • Dhënia e një spektakli të vërtetë për të gjithë shikuesit direkt dhe të gjithë teleshikuesit. • Lartësimi i vlerave të këtij sporti.
Përfitues nga ky Projekt	<ul style="list-style-type: none"> • Dashamirësit e këtij sporti. • Pjesëmarrësit në këtë aktivitet. • Partnerët në këtë projekt veçanërisht sponsorët.
Përfitimet e Donatorëve	<p>Sporti në përgjithësi është argëtim për të gjithë ato që marin pjesë në të, por edhe për shikuesit. Basketbolli, në ndryshim nga sportet e tjera, ka një veçanti në mënyrën e lojës së tij. Shpejtësia e lojës, kombinimi në pasime, gjuajtjet nga distanca, kapjet e topit në lartësi, futjet e topit nga lart me kërcim, zgjuarsia e lojtarëve, mënyra se si e organizohet loja në basketboll etj, i dhuron spektatorëve kënaqësinë e një spektakli të vërtetë. Nga sa thamë më sipër ne mendojmë të afrojmë sa më shumë spektatorë, po ashtu të tërheqim vëmendjen mediave vizive dhe atyre të shkruara lokale dhe atyre kombëtare në mënyrë që partnerët, në veçanti, sponsorët e këtij projekti të përfitojnë sa më shumë nga ky eveniment. Duke realizuar këtë projekt, në shkëmbim të mbështetjes që sponsorët do të japin, ne me të gjitha mundësitë tona, do t'i ofrojmë atyre promovim apo reklamim me anë të posterave që do të vendosen në vendet e zhvillimit të projektit, me reklama apo me njoftime ne media vizive ose të shkruara dhe me prezantimet para secilës ndeshje.</p>

Transmetimi Direkt në TV	E drejta televizive për transmetimin e këtij evenimenti, do të përcaktohet nga FSHB para fillimit të aktivitetit.
---------------------------------	---

ÇFARË DO TË JAPIM NE (INPUT)

- (Vënia në lëvizje e stafit të Sponsorëve/Partnerët)
- Shfrytëzimin e diturive tona në organizimin sa më të mire të këtij projekti.
- Vënia në lëvizje e bashkëpunëtorë tonë në basketboll.
- Bashkëpunimin tonë me mediat e shkruara dhe vizive, lokale dhe kombëtare.
- Bashkëpunim me partnerët tanë në këtë projekt.
- Angazhimin e stafit të ngritur për këtë qellim.

RREZULTATET E PRITURA (OUTPUT)

- Përfundimi i këtij projekti në mënyrë të suksesshme.
- Aktivizimi masiv i të gjithë të interesuarve të këtij sporti në këtë aktivitet.
- Shtimin e interesit të publikut, për të marrë pjesë në të tillë aktivitete.
- Afrimin e lojtarëve të rinj, në të gjitha klubet apo shoqata në Republikën e Shqipërisë.
- Një shfaqje e bukur në fundjavë për të gjithë spektatorët.
- Krijimin e një simpatie për kompanitë donatore tek qytetarët gjithashtu edhe afrimin e klientëve të rinj në këto kompani.

SHPËRBLIMI PËR EKIPET FITUESE

Për të motivuar një pjesëmarrje sa më të gjerë kemi vendosur që ekipet fituese të jenë tre, vendi i parë, vendi i dytë dhe vendi i tretë sepse në këtë mënyrë loja do të ketë interes më shumë dhe do të bëhet më e bukur.

1. Ekipi i parë fitues Kupë, medalje.
2. Ekipi i dytë fitues diplomë.
3. Diplomë për çdo skuadër pjesëmarrëse.
4. Çmime speciale (lojtari më i mirë për çdo skuadër, lojtari më atraktiv, etj).

Gjithashtu mendojmë të zhvillojmë lojëra me spektatorët ndërmjet ndeshjeve që t'iu dhurojmë atyre argëtim të vërtetë, lojëra si: gjuajtje nga distanca, gjuajtje mbrapsht, gjuajtje me sy të



NË KUADËR TË 100-VJETORI T TË PAVARSI SË
FSHB ORGANI ZON:
"Bam-Passarella 2012"



lidhur etj, duke u shpërndarë dhurata simbolike fituesve, që do të sponsorizohen nga donatorë të ndryshëm.

ÇFARË DO TË JAPIM NE KONKRETISHT PËR SPONSORAT TANË

Për t'i ofruar donatorëve tanë një promovim apo një reklamim ndryshe. Ne stafi i FSHB-së, në bashkëpunim me partnerët e këtij projekti do të bëjmë një organizim sa më të mire, në mënyrë që të ketë një ndikim të madh tek spektatorët dhe të interesuarit. Kështu, ne do vendosim banera apo reklama që do të sigurohen nga sponsorët. Gjithashtu kërkojmë nga ata, që të vënë në dispozicion një staf në mënyrë që të tregtojnë produktet e tyre në vendet e zhvillimit të aktivitetit. Programi për secilën ditë të zhvillimit të këtij evenimenti do të jetë i ndërthurur në atë mënyrë, që në çdo pushim prezantuesi, përveç të tjerash të falënderojë në radhë të pare sponsorët e këtij projekti. Për të krijuar një audiencë sa më të gjerë ne menduam të nxjerrim lajmërim në media audio-vizive dhe të shkruara lokale dhe, nëse është mundur, edhe ato kombëtare, ku do të prezantojmë edhe sponsorët. Gjithashtu do të përgatisim disa postera për njoftim, ku do të vendosen edhe logot e kompanive sponsorizuese të cilat do të shpërndahen në qytetet dhe komunat e zhvillimit të këtij evenimenti.

KALENDARI I ZHVILLIMIT TË VEPRIMTARISË

Ndarja në dy grupe me nga gjashtë ekipe.

Grupi A

Superior Klima 1
Marsi Basket 2
Sonia Basket 1
Studenti 2
Teuta
ABC Valbona

Grupi B

Superior Klima 2
Marsi Basket 1
Sonia Basket 2
Studenti 1
Shkodra Basket
Tirana

Formula e Kalendarit:

Faza e parë:

Në bazë të shorteut, ekipet do të ndeshen si më poshtë:

Dita e parë, 24 - 25 mars 2012.

Grupi A

6 v 1
5 v 2
3 v 4

Grupi B

6 v 1
5 v 2
3 v 4

Dita e dytë, 31 mars -1 prill 2012.

Grupi A

1 v 5
4 v 6
2 v 3

Grupi B

1 v 5
4 v 6
2 v 3

Dita e tretë, 7 - 8 prill 2012.

Grupi A

4 v 1
3 v 5
6 v 2

Grupi B

4 v 1
3 v 5
6 v 2

Dita e katërt, 14 - 15 prill 2012.

Grupi A

1 v 3
2 v 4
5 v 6

Grupi B

1 v 3
2 v 4
5 v 6

Dita e pestë, 21 - 22 prill 2012.

Grupi A

2 v 1
6 v 3
4 v 5

Grupi B

2 v 1
6 v 3
4 v 5

Në bazë të një shorteu që do të hidhet pas mbarimit të ditës së pestë, do të percaktohet kalendari për gjashtë ekipet më të mira (tre nga grup A dhe tre grupi B), do të kualifikohen për në fazën e dytë.

Faza e dytë:

Dita e gjashtë, 29 - 30 prill 2012.

6 v 1
5 v 2
3 v 4

Dita e shtatë, 5 - 6 maj 2012.

1 v 5
4 v 6
2 v 3

Dita e tetë, 12 - 13 maj 2012.

4	v	1
3	v	5
6	v	2

Dita e nëntë, 19 - 20 maj 2012.

1	v	3
2	v	4
5	v	6

Dita e dhjetë, 26 - 27 maj 2012.

2	v	1
6	v	3
4	v	5

Në bazë të renditjes, katër ekipet e para do të kualifikohen për në Final-Four.

Faza finale:

Final-Four, 1 qershor 2012.

Ndeshja 1:	1	v	4
Ndeshja 2:	2	v	3

Fituesi 1	v	Fituesi 2
------------------	---	------------------